



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 72

Prishtinë, më 15.5.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina.

Mungoi : Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH me Arben Çitakun, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO, KDI, OSBE, Presidenca, NDI-Shefki Kastrati, Ambasada Amerikane, dy ekspertët E. Surdulli dhe F. Selmani) dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 14.5.2012,
3. Projektligji për Ndërtimin,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.5.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.5.2012.

3. Projektligji për Ndërtimin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti dhe falënderoj të pranishmit duke filluar me shqyrtimin e Projektligjit nga Neni 22 deri në fund. Stafi ka evidentuar ndryshimet dhe propozimet për ndryshime, ndaj kryetari ka sugjeruar që në mbledhjen e nesërme të përfundoj shqyrtimi i Projektligjit pas diskutimeve përfundimtare në komision, duke hartuar amendamentet konkrete. **Liburn Aliu** në shenjë proteste lëshoi mbledhjen gjatë shqyrtimit të Nenit 28 për shkak të konceptit të gabuar në Projektligj të mbikëqyrjes për kontroll të shtetit ndaj ndërtimit. Nga mbledhja gjithashtu u largua eksperti **Feti Selmani** i cili kishte mospajtime me disa anëtarë të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 17,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani